



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.01.2023

Nr: 05

Ora: 12:30

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 12, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25, 26, dhe 27

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 16.01.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: TV Mati; Club TV; A2CNN (G2 Media); TV Klaudiana; Radio Saranda Televizion; TV Berati; Glob TV; TV Alpo (AMG 2000); TV Apollon; TV Kopliku; TV Best Channel; TV-Era-Digitalb; Televizioni Kukës.

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr. 12 datë 12.12.2022; nr. 13, datë 12.12.2022; nr. 14, datë 13.12.2022; nr. 17, datë 20.12.2022; nr. 18, datë 21.12.2022; nr. 19, datë 23.12.2022; nr. 20, datë 27.12.2022; nr. 21, datë 30.12.2022; nr. 22, datë 06.01.2023; nr. 23, datë 06.01.2023; nr. 25, datë 06.01.2023; nr. 26, datë 06.01.2023 dhe nr. 27, datë

06.01.2023 me objekt: Kundërshtimin e vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021”.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124/1, 133, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe neni 30 i vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Rrethanat e çështjes:

1. Në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, me vendimin nr. 224, datë 07.12.2022. Në vendimin e sipërcituar, ndër të tjera, Komisioneri vendosi marrjen e masës administrative me gjobë për disa Ofrues të Shërbimit Mediatik Audiovizivë (OSHMA), si më poshtë vijon:
 - Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audiovizivë (OSHMA) Tv Mati; Club TV, TV-Era-Digitalb; Tv Klaudiana; Radio Saranda Televizion; TV Berati; Glob TV; TV Apollon; TV Koplik; TV Kukës sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor, për shkak të mosdorëzimit të tarifave zyrtare;
 - Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audiovizivë (OSHMA) TV Best dhe A2CNN (G2 Media), sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor, për shkak tejkalimi të minutazhit të transmetimit të reklamave politike.

2. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur kërkesa ankimore OSHMA-të: **TV Mati; Club TV; TV Klaudiana; Glob TV; TV Alpo (AMG 2000); TV Apollon; TV Kopliku; TV-Era-Digitalb; Radio Saranda TV; Televizioni Kukës**. Në ankimin e tyre pretendojnë se nuk kanë marrë kërkesa nga asnjë subjekt politik si dhe nuk kanë transmetuar asnjë reklamë politike gjatë fushatës zgjedhore. Për këto arsye, nuk e kanë gjykuar të domosdoshëm dorëzimin e tarifave zyrtare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore edhe OSHMA **A2CNN (G2 Media)**. Në kërkesën e tyre pretendojnë se kanë transmetuar vetëm 6.97 minuta më tepër se parashikimi i nenit 84/5 i Kodit Zgjedhor. Masa administrative me gjobë në vlerën 50.000 lek është e ekzagjeruar dhe jo në proporcion me shkeljen. Me të njëjtën vlerë janë sanksionuar dhe OSHMA të tjera, të cilat e kanë tejkualuar transmetimin e minutazhit të reklamave politike disa herë më shumë se parashikimi i nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor. Ky subjekt ankimes ka kërkuar rivlerësim të masës së gjobës në proporcion me masën e tejkalimit të minutazhit.
4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore OSHMA **TV Berati**. Në kërkesën e tyre pretendojnë se kanë dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve tarifën e caktuar si dhe nuk kanë transmetuar asnjë reklamë politike gjatë fushatës zgjedhore.
5. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore edhe OSHMA **TV Best**. Në kërkesën e tyre pretendojnë se kanë transmetuar në përputhje me ligjin 90 minuta reklamë politike, por në raport janë paraqitur 91 minuta dhe 0.6 sekonda, pra një gabim prej më pak se 0.1%, duke e konsideruar si një lapsus ose gabim njerëzor.
6. Kërkesat ankimore iu paraqitën KAS-it, i cili paraprakisht, me vendimet nr. 25, datë 19.12.2022 dhe nr. 2, datë 17.01.2023 vendosi pranimin për shqyrtim dhe bashkimin e tyre në një çështje të vetme me relator z. Ledio Braho, duke caktuar seancën e shqyrtimit administrativ në datën 17.01.2023, ora 12:30.
7. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.224, datë 07.12.2022 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të

- shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021” së bashku me Shtojcën 1 bashkëlidhur vendimit;
- kërkesat ankimore nr. 12 datë. 12.12.2022; nr. 13, datë 12.12.2022; nr. 14, datë 13.12.2022; nr. 17, datë 20.12.2022; nr. 18, datë 21.12.2022; nr. 19, datë 23.12.2022; nr. 20, datë 27.12.2022; nr. 21, datë 30.12.2022; nr. 22, datë 06.01.2023; nr. 23, datë 06.01.2023; nr. 25, datë 06.01.2023; nr. 26, datë 06.01.2023; nr. 27, datë 06.01.2023;
 - në lidhje me njoftimet që administrata e KQZ i ka dërguar OSHMA-ve përpara nisjes së fushatës zgjedhore në raport me detyrimin e këtyre të fundit për të dorëzuar tarifat për çdo segment kohor pranë KQZ, ato nuk u administruan si provë duke qenë se këto njoftime sipas administratës së KQZ janë dërguar nëpërmjet postës elektronike, por që tashmë është e paaksesueshme për shkak të sulmeve kibernetike që ka pësuar rrjeti gjatë vitit 2022;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-I konstatoi:

Për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, pas përfundimit të tyre, është kryer dhe auditi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje. Pas kryerjes së këtij auditi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021” ka vendosur ndër të tjera *“Miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi”*. Po ashtu, sipas Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga verifikimi i monitorimit të fushatës në media:

- 54 OSHMA janë në shkelje të nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor e për rrjedhojë për secilën prej tyre është marrë masa administrative me gjobë në zbatim të nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor në masën nga 30,000 deri në 50,000 lekë

- 2 OSHMA janë në shkelje të nenit 84 pika 6 të K.Zgjedhor e për rrjedhojë për secilën prej tyre është marrë masa administrative me gjobë në zbatim po të nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor në masën 70,000 lekë;
- 5 OSHMA janë në shkelje të nenit 92/6 pika 6 të K.Zgjedhor e për rrjedhojë për secilën prej tyre është marrë masa administrative me gjobë në zbatim të nenit 173 pika 8 të K.Zgjedhor në masën 100,000 lekë.

Në lidhje me dispozitat e K.Zgjedhor që pretendohen se janë shkelur nga OSHMA-të e sipërcituara, ato janë sipas përmbajtjes si vijon:

Neni 84 pika 5 e K.Zgjedhor parashikon se *“Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. Operatorët radiotelevizivë në çdo rast zbatojnë tarifa të njëjta brenda të njëjtit segment kohor përgjatë gjithë kohës së fushatës. Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo segment kohor pranë KQZ-së. Tarifat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”*.

Neni 84 pika 6 e K.Zgjedhor parashikon se *“Për zgjedhjet në Kuvend radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, sipas këtij neni, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës së parashikuar në pikën 5 të këtij neni t’ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore. Kostoja për vënien e kohës në dispozicion falas subjekteve zgjedhore nga ana e radiove dhe televizioneve private llogaritet si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore. Ngarkohen KQZ-ja, enti rregullator për mediat audiovizive dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse”*.

Neni 92/6 pika 6 e K.Zgjedhor parashikon se *“KQZ-ja ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, raportin e auditimit sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe çdo informacion tjetër për lëndën për të cilin vihet në dijeni. KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t’i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji”*.

Neni 171 pika 1 e K.Zgjedhor parashikon se *“Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë”*.

Neni 173 pika 8 e K.Zgjedhor parashikon se *“Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë”*.

Pavarësisht dispozitave të sipërcituara, KAS në këtë vendimmarrje do të trajtojë vetëm shkeljet e pretenduara në zbatim të nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor të sanksionuara sipas nenit 171 pika 1 të këtij kodi, pasi subjektet ankimuese i përkasin vetëm OSHMA-ve që janë sanksionuar në bazë të kësaj dispozite.

Si fillim është për t'u theksuar fakti se neni 84 në tërësinë e tij, përfshirë këtu dhe pikën 5, është riformuluar sipas përmbajtjes aktuale me ndryshimet që K.Zgjedhor ka pësuar me ligjin nr. 74/2012 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*”, pra është në fuqi që nga vitit 2012. Te vetmet ndryshime që janë kryer më vonë, më konkretisht në vitin 2020, janë shkronja *“d”* në pikën 2 të këtij neni dhe ndryshimi i afatit në pikën 10 të tij, ndryshime këto që nuk lidhen me shkeljet e pretenduara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për OSHMA-të ankimuese në këtë shqyrtim administrativ.

Po ashtu është për t'u theksuar që me ndryshimet e K.Zgjedhor të vitit 2020, u riformatua edhe vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga një organ i vetëm kolegjal, tashmë funksionon nëpërmjet tre organeve drejtuese, një prej të cilëve është edhe Komisioni Rregullator, i cili në zbatim të nenit 12 pika 4 të K.Zgjedhor *“... është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet”*. Neni 20 i K.Zgjedhor që detajon kompetencat e Komisionit Rregullator, në pikën 1 shkronja *“ç”* të tij parashikon se *“Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për: ... ç) rregullat për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore”*. Në zbatim të këtij parashikimi, Komisioni Rregullator ka miratuar vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 *“Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”*.

Neni 84 i K.Zgjedhor, nga vetë titulli që ka – “*Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private*” – e bën të qartë që trajton dhe rregullon vetëm veprimtarinë e radiove dhe televizioneve private në fushatë zgjedhore, në ndryshim nga nenet 80 – 83 të K.Zgjedhor që trajtojnë veprimtarinë e radiotelevizionit publik në fushatë zgjedhore si në raport me subjektet zgjedhore, por po ashtu edhe me vetë KQZ. **Për shkak të statusit të ndryshëm të këtyre mediave (publik/privat), K.Zgjedhor bën diferencim mes tyre, ku përcakton se në radiotelevizionin publik reklamat politike transmetohen pa pagesë (neni 80 pika 3 e K.Zgjedhor) ndërkohë që radiot dhe televizionet private zbatojnë tarifa të njëjta brenda të njëjtit segment kohor përgjatë gjithë kohës së fushatës (neni 80 pika 5 e K.Zgjedhor).** Po në të njëjtën dispozitë përcaktohet dhe minutazhi maksimal që një radio apo televizion privat mund të transmetojë si reklama politike, që nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar në zgjedhje. **Në kuptim të kësaj dispozite, një OSHMA-je private i përcaktohet vetëm maksimumi i minutazhit që mund të transmetojë reklama politike, çka e lë në zgjedhje të vetë OSHMA-ve private që edhe të mos transmetojnë asnjë reklamë politike gjatë fushatës zgjedhore.** Pikërisht ky është argumenti që OSHMA-të ankimuese TV Mati, Club TV, TV Klaudiana, Glob TV, TV Alpo (AMG 2000), TV Apollon, TV Kopliku, TV-Era-Digitalb, Radio Saranda TV, Televizioni Kukës dhe TV Berati kanë pretenduar në lidhje me mosdorëzimin e tarifave për segmentet kohore përgjatë kohës së fushatës. Sipas tyre, ato nuk kanë pasur për qëllim të transmetojnë reklama politike gjatë kohës së fushatës për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill 2021 dhe për këtë arsye nuk e kanë parë të arsyeshme që të dorëzojnë tarifa për minutazhin për reklamat politike.

Në lidhje me faktin nëse OSHMA-të private zgjedhin të transmetojnë apo jo reklama politike, një zgjedhje e tillë bazohet në nenin 11 të Kushtetutës që parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Sipas pikës 3 të këtij neni, kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Sa i përket kufizimit, në këtë rast ligjvënësi ka parashikuar si të arsyeshëm vetëm faktin që nëse një OSHMA vendos të transmetojë reklama politike, atëherë tarifat për këto reklama do të jenë të njëjta për çdo subjekt zgjedhor sipas segmenteve kohore dhe që nuk mund t’i ofrojë më shumë se 90 minuta kohë. OSHMA-të e sipërcituara, nga vetë verifikimi që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka bërë sipas Shtojcës 1 bashkëlidhur vendimit objekt ankimi, rezultojnë që nuk kanë transmetuar asnjë reklamë

politike dhe në pretendimet e tyre para KAS pranuan se ka qenë vullneti i tyre për të mos transmetuar reklama politike që përpara nisjes së fushatës zgjedhore.

Elementi i parë që vlen për t'u sqaruar në lidhje me mungesën e vullnetit të këtyre OSHMA-ve për të transmetuar reklama politike gjatë fushatës zgjedhore, e për rrjedhojë edhe për mosdorëzimin e tarifave për segmentet kohore gjatë fushatës, është ai i historikut të ndjekur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që nga hyrja në fuqi e kësaj dispozite në vitin 2012. Nga viti 2012 deri në vitin 2021 janë zhvilluar më shumë se 4 herë zgjedhje dhe asnjë OSHMA nuk është dënuar administrativisht për mosdorëzim të tarifave për reklamat politike. Pavarësisht mosveprimit të KQZ në të kaluarën, që nuk mund të shërbejë si argument për vendimin objekt shqyrtimi administrativ, për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill 2021, për shkak të detyrimit që Komisioni Rregullator kishte, më konkretisht atë të shqyrtimit dhe miratimit të rregullave për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore, do duhej të rregullonte edhe mënyrën e shprehjes së vullnetit nga OSHMA-të private brenda afatit të përcaktuar në nenin 84 pika 5 të K.Zgjedhor për të mos transmetuar reklama politike gjatë fushatës zgjedhore. Sipas vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive" të Komisionit Rregullator, edhe pse në bazën ligjore të tij është parashikuar edhe neni 84 i K.Zgjedhor, nuk vërehet ndonjë parashikim në lidhje me OSHMA-të që zgjedhin me vullnetin e tyre për të mos transmetuar reklama politike, kur vetë K.Zgjedhor e lë të lirë këtë zgjedhje për aq kohë sa e konsideron si një të drejtë të tyre dhe jo detyrim transmetimin e reklamave politike.

Për sa më sipër, në lidhje me OSHMA-të ankimuese TV Mati, Club TV, TV Klaudiana, Glob TV, TV Alpo (AMG 2000), TV Apollon, TV Kopluku, TV-Era-Digitalb, Radio Saranda TV, Televizioni Kukës dhe TV Berati, për aq kohë sa:

- K.Zgjedhor e konsideron si një të drejtë të tyre dhe jo detyrim transmetimin e reklamave politike;
- ka një vakum ligjor sa i përket mënyrës së shprehjes së vullnetit nga ana e tyre kundrejt KQZ-së për mostransmetim të reklamave politike; dhe po ashtu
- nga monitorimi i kryer nuk ka rezultuar që ndonjë prej tyre të ketë transmetuar reklama politike gjatë fushatës së zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë ta datës 25 prill 2021;

atëherë akti administrativ vendimi nr. 224, datë 07.12.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021”, sa i përket dënimeve administrative me gjobë të vendosura ndaj këtyre OSHMA-ve është i paligjshëm pasi është në kundërshtim me ligjin material.

Në lidhje me ankimimet e OSHMA-ve A2CNN (G2 Media) dhe TV Best të cilat respektivisht kanë tejkalar minutazhin e përcaktuar në nenin 84 pika 5 të K.Zgjedhor me 6.97 dhe 1.6 minuta dhe për këtë tejkalim secila prej tyre është dënuar administrativisht me gjobë në vlerën 50.000 lekë, KAS si fillim do të trajtojë qëllimin e kësaj dispozite.

Më konkretisht, fjalia e parë e pikës 5 të nenit 84 të K.Zgjedhor parashikon se *“Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje”*. Në kuptim të kësaj dispozite duket qartë që ligjvënësi, pavarësisht buxheteve të partive politike, ka vendosur një maksimum të minutazhit për partitë e regjistruara për zgjedhje edhe në OSHMA-të private dhe kjo me qëllimin e vetëm për të pasur barazi dhe pluralizëm në propagandën zgjedhore. Nga raporti bashkëlidhur vendimit objekt shqyrtimi administrativ, në pikën VI.1 të tij është pasqyruar tejkalimi i minutazhit nga radiot dhe televizionet private nga ku rezulton se janë 21 OSHMA që e kanë tejkalar minutazhin e përcaktuar në K.Zgjedhor. **Nga tabela që i bashkëlidhet këtij raporti, rezultojnë OSHMA që e kanë tejkalar me qindra minuta minutazhin në raport me atë që parashikon K.Zgjedhor, por dënimet administrative të vendosura nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve janë të gjitha në masën 50,000 lekë, çka për KAS konsiderohen si në shkelje të kriterëve për caktimin e masës së dënimit.** Më konkretisht, ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në nenin 18 të tij që përcakton kriteret për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit parashikon se:

“Në përzgjedhjen e llojit të dënimit dhe në caktimin e masës së tij, në rastet kur ligji ka parashikuar kufij minimalë e maksimalë të vlerës së gjobës, organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh:

a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;

b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;

c) rëndësinë e kundërvajtjes;

ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi”.

Megjithatë, sa i përket tejkalimit të minutazhit nga dy OSHMA-të ankimore, që janë me 6.97 dhe 1.6 minuta, marzhe të tilla mund të vijnë si pasojë e gabimit njerëzor, por ajo çka është më kryesorja, qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë dënimi administrativ për tejkalime të kësaj sasive, por për ato që e tejkalojnë minutazhin në sasi më të konsiderueshme. Në vijim të këtij argumenti, KAS, gjatë seancës së shqyrtimit administrativ, krijoi bindjen se tejkalimi i minutazhit me 6.97 dhe 1.6 minuta nga këto dy OSHMA gjithsesi tregon qëllimin e tyre për të respektuar ligjin ndaj tejkalime të tilla nuk mund të konsiderohen si në shkelje të K. Zgjedhor. Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në nenin 4 të tij i përkufizon kundërvajtjet administrative si *“shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim”*, për rrjedhojë për KAS është e vështirë të krijohet bindja se këto dy OSHMA e kanë konsumuar elementin e fajit për aq kohë sa në 30 ditë fushatë zgjedhore, transmetimi i reklamave politike ka qenë sërish në tejkalim të limitit brenda atyre marzheve që mund të konsiderohen edhe pasojë e gabimit njerëzor. Po ashtu, edhe K.Pr.Administrative në nenin 109 shkronja “e” të tij parashikon se *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: ... e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit”*, që është rasti klasik për këto dy OSHMAA.

Për sa më sipër, akti administrativ vendimi nr. 224, datë 07.12.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021”, edhe sa i përket dënimeve administrative me gjobë të vendosura ndaj OSHMA-ve A2CNN (G2 Media) dhe TV Best është i paligjshëm pasi nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Pavarësisht kërkesës ankimore dhe parashtrimeve të përfaqësuesit ligjor të OSHMA A2CNN (G2 Media) gjatë seancës së shqyrtimit administrativ vetëm për rivlerësimin e masës së dënimit administrativ me gjobë në respektim të parimit të proporcionalitetit, KAS, në zbatim të nenit 143 pika 2 të K.Zgjedhor që parashikon se *“KQZ-ja merr vendim, sipas njërit nga rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pavarësisht nga ajo çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij”* si dhe në funksion të vendosjes së standardeve të jurisprudencës zgjedhore, ka arritur në përfundimin se edhe dënimi administrativ i vendosur ndaj këtij subjekti duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja 'b' dhe 143 shkronja "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesave ankimore nr. 12 datë. 12.12.2022, nr. 13, datë 12.12.2022, nr. 14, datë 13.12.2022, nr. 17, datë 20.12.2022, nr. 18, datë 21.12.2022, nr. 19, datë 23.12.2022, nr. 20, datë 27.12.2022, nr. 21, datë 30.12.2022, nr. 22, datë 06.01.2023, nr. 23, datë 06.01.2023, nr. 25, datë 06.01.2023, nr. 26, datë 06.01.2023 dhe nr. 27, datë 06.01.2023 të paraqitura nga OSHMA-të TV Mati, Club TV, A2CNN (G2 Media), TV Klaudiana, Radio Saranda Televizion, TV Berati, Glob TV, TV Alpo (AMG 2000), TV Apollon, TV Kopliku, TV Best Channel, TV-Era-Digitalb dhe Televizioni Kukës;
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021" për dënimet administrative me gjobë të vendosura ndaj OSHMA-ve TV Mati, Club TV, A2CNN (G2 Media), TV Klaudiana, Radio Saranda Televizion, TV Berati, Glob TV, TV Alpo (AMG 2000), TV Apollon, TV Kopliku, TV Best Channel, TV-Era-Digitalb dhe Televizioni Kukës;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio BRAHO - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**